

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Fejzullah Rexhepi dhe Rafet Haxhaj si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses S.S. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson N.H., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës NLB-Prishtina, për shkak të kompensimit të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesave të autorizuarit të paditëses dhe të paditurës, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2939/2013, i dt.30.06.2014, në seancën jo publike të mbajtur më dt. 03.06.2016, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHEN** si e pa bazuara ankesat e të autorizuarit të paditëses S.S. nga Prishtina – avokatit N.H. nga Prishtina dhe të paditurës NLB-Prishtina dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2939/2013, i dt.30.06.2014.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditëses dhe është detyruar e paditura ish Banka e Re e Kosovës, tani NLB nga Prishtina që paditëses për shkak të largimit jo ligjor na puna në emër të pagave të perealizuara për periudhën kohore nga data 01.04.2006 e deri me 31.12.2013 ti kompensoj shumën neto të parave në vlerë prej 29.838,86 €, në emër të kontributit pensional të paditëses në trustin pensional ti kompensoj shumën prej 1.363,38 €, ndërsa në emër të tatimit nga paga shumën prej 1.374,48 €, bashkë me kamatën në shumë prej 1.374,38 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 420 €.

Kundër këtij aktgjykimi, i autorizuari i paditëses dhe e paditura në afatin ligjor kanë ushtruar ankesa dhe atë, i autorizuari i paditëses për shkak vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar, ashtu që paditëses t'ia njoh kompensimin e pagës për periudhën e cekur si në precizim të kërkesëpadisë, ose ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ndërsa e paditura aktvendimin e cekur më lartë e atakon nga shkaqet e parapara në dispozitën e nenit 181.1 të LPK-së, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshoj

aktgjykimin e atakuar dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzon si të pabazuar.

Përgjigje në ankesa nuk ka pasur.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

### **Ankesat janë të pabazuara.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja S.S. nga Prishtina përmes të autorizuarit të saj në precizimin e kërkesëpadisë ka kërkuar që të obligohet e paditura NLB-Prishtina që t'ia bëjë kompensimin e të ardhurave personale, me të dhëna si në precizimin e kërkesëpadisë si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në riprocedurë ka bërë nxjerrjen e provave përmes leximit të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.188/2007 të datës 09.10.2009, aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.382/2010 të datës 13.11.2012, aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.119/2013 të datës 22.10.2013, ekspertizën nga ana e ekspertes financiare M.M. të datës 26.03.2014 dhe nga provat e nxjerra më lartë dhe deklarimet e ndërgjyqësve ka rezultuar se nuk ishte kontestues fakti se me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.188/2007 të datës 09.10.2010 është aprovuar kërkesëpadia e paditëses për anulimin e vendimit të paditurës dhe kthimit të paditëses në vendin e mëparshëm të punë, gjithashtu nuk ishte kontestues fakti në bazë të aktgjykimit të cekur më lartë pse e paditura nga muaji Janar 2005 e gjer me datë 31.03.2006 paditëses ia ka kompensuar të ardhurat nga marrëdhënia e punës, ndërsa në muajin Janar i vitit 2014 paditësen e ka rikthyer në punë, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të cekur më lartë Rev.nr.119/2013 i datës 22.10.2013 aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe i Gjykatës Komunale në Prishtinë janë prishur në pjesën me të cilën paditëses i janë njohur të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, ashtu që në rigjykim sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pala paditëse është dashtë ta bëjë precizimin e kërkesëpadisë dhe të përcakton se cilat të drejta i kërkon nga marrëdhënia e punës. Pasi që paditësja përmes të autorizuarit të saj e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar kompensimin e pagës nga marrëdhënia e punës të cilat do ti realizonte për periudhën kohore 01.04.2006 gjer me 31.12.2013, ndërsa në anën tjetër duke pas parasysh se baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të cekur më lartë, e gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 14 të Ligjit Themelor të Punës, si ligj i zbatueshëm në rastin e paditëses, e ka aprovuar kërkesëpadinë

e precizuar të paditëses dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar pasi që gjykata me rastin e caktimit të lartësisë të kompensimit të ardhurave personale të papaguara e ka bazuar në ekspertizën e ekspertes financiare.

Kjo gjykatë, duke e vlerësuar përfundimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është i drejtë, i bazuar në ligj dhe ka mbështetje në dispozitat ligjore, si dhe në shkresat e lëndës, ndërkohë që janë dhënë edhe arsyet e justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet ankimore të palës paditëse dhe të paditur kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, pasi që me aktgjykimet e cekura më lartë është vërtetuar baza e kërkesëpadisë të paditëses, ndërsa lartësia për kompensimin e të ardhurave personale të cekura si më lartë, gjykata e ka bazuar në ekspertizën e ekspertes financiare, e cila me rastin e kryerjes të ekspertizës llogaritjen e pagës e ka kryer duke marrë për bazë rregulloret dhe legjislacionin që kanë të bëjnë me paga, si dhe siç cek e njëjta eksperte është respektuar çdo ndryshim në rregullore dhe legjislacion të ardhurave personale në Kosovë për periudhën për të cilën e ka bërë llogaritjen e të ardhurave personale.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195 par.1 d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Ac.nr.4408/2014 më dt.03.06.2016**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Ramë Hyseni**

**SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE**

*Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt. 03.06.2016, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

*Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.*

**Vërtetojnë:****Anëtarët e kolegjit****Kryetari i kolegjit**

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_